

Rregullat e reja për vizitorët për të reduktuar përhapjen e koronavirusit

New York State Department of Health (Departamenti i Shëndetit i Shtetit të Nju-Jorkut) ka nxjerrë politika të reja për vizitat e vizitorëve të spitaleve dhe ofruesit e kujdesit.

Duke filluar nga data 18 mars 2020, të gjitha vizitat e pacientëve në NYC Health + Hospitals PEZULLOHEN, përveç:

- + Kur është e nevojshme nga ana mjekësore dhe vizitori është i rëndësishëm për shëndetin e pacientit;
- + Vizitori është anëtar i familjes ose përfaqësues ligjor i pacientit, i cili është në gjendje drejt fundit të jetës; ose
- + Për një vizitor të një grua gjatë lindjes, të një foshnjë në terapi intensive neonatale (ICU) ose të një pacient pediatrik.

Përpara se të hyjë në spital, çdo vizitor që përmbush përjashtimet e mësipërme, duhet të testohet nëse ka simptoma të kollës, vështirësi në frymëmarrje ose ethe, ose nëse ka pasur kontakt të mundshëm me dikë me COVID-19.

Vizitorët të cilët shfaqin simptoma të COVID-19 ose kanë pasur kontakt me dikë me COVID-19 nuk do të lejohen të vizitojnë pacientët.

Kohëzgjatja e vizitave dhe numri i vizitorëve do të jetë i kufizuar.

